



Dalës- Izlazna

Nr. -1-72
Br.

Data 02.06.2023
Datum



OPŠTINA OBILIĆ

Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government



Komuna Obiliq – Opštine Obilić - Municipality Obiliq
Zyra e Kryetarit

Në mbështetje të neneve 12.2, pika (d), nenit 12.1, nenit 17 shkronja (b), nenit 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës nr. 03/L-40 (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 5 paragrafi 1.2 pika 1.2.1, neni 6 paragrafi 1.2 pika 1.2.1, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.2 dhe nënpika 2.2.1, nenit 11 dhe nenit 15 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.30/2013” dhe Udhëzimit Administrativ MMPH –NR. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, si dhe Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr.08/2017 për normat teknike të Planifikimit Hapësinor dhe Vendimit për dhënie e pëlqimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Obiliqit 2023-2031 Njësia Org.SP-02; me Nr.prot.2751-2/23 të dt.25.05.2023 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nenit 72 pika 1.8, nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34, të dt.25.04.2016, si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, pas shqyrtimit të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, nr.-II-718, të dt.26.05.2023, dhe kërkesës së DPUKP-së, nr.-V-555, të dt.26.05.2023, Kuvendi Komunal në Mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me dt.02.06.2023 mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e dokumentit të Planifikimit Hapësinor- Plani Zhvillimor i Komunës së Obiliqit 2023-2031

Neni 1

MIRATOHET Vendimi për dokumentin e Planifikimit Hapësinor- Plani Zhvillimor i Komunës së Obiliqit 2023-2031 për periudhën 8 (tetë) vjeqare, si një projekt –plan multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor duke përfshirë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për tërë territorin e Komunës së Obiliqit me sipërfaqe prej 104.84 km².

Neni 2

2.1 “Plani zhvillimor Komunal i Obiliqit 2023-2031” përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik për tërë territorin e Komunës, mbi të cilat do të bazohet hartimi i hartës zonale të Komunës së Obiliqit.

2.2 Pjesë përbërse e këtij vendimi të Kuvendit është “Plani Zhvillimor Komunal i Obiliqit 2023-2031” i hartuar nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Pronë dhe Kadastër si bartëse e procesit duke u bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.30/2013”, Udhëzimin Administrativ MMPH – NR. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, Udhëzimi Administrativ MMPH-Nr.08/2017 për normat teknike të Planifikimit Hapësinor dhe Vendimi

për dhënien e pëlqimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Obiliqit 2023-2031 Njësia Org.SP-02; Nr.prot.2751-2/23 Dt.25.05.2023 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës .

2.3.Plani Zhvillimor Komunal i Obiliqit 2023-2031” në vete përmban pjesën tekstuale dhe pjesën grafike, Vendimin Nr.Prot.3963-2/20 Dt.22.09.2020 për Pëlqimin Mjedisor për raportin e vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Obiliqit dhe Raportin e Shqyrtimit Publik të cilat po ashtu janë pjesë përbërse të këtij vendimi .

Neni 3

Pas miratimit të këtij vendimi për zbatimin e tij do të kujdesen të gjitha organet e komunës së Obiliqit nën mbikqyrjen e Drejtorisë së Planifikimit Urban , Pronë dhe Kadastër .

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Kuvendit Komunal me nr. protokollit 01-166/10 Dt.26.07.2010 për miratimin e e Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban të Obiliqit 2009-2020+ .

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-së dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës .

-T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- DPUKP
- MAPL
- MMPHI
- Arkivit

